



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.05.2025
Numër Protokolli: 3295/2025

A.nr.464/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.464/2025 të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesja A.I, kundër organit të punësimit: Komuna e Kllokotit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.464/2025, e datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesja A.I.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 90, i datës 11.02.2025, për rezultatin final të vlerësimit, të pozitës së punës *Zyrtar për Shërbime Sociale 2*, në Komunën e Kllokotit.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, A.I (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 13.03.2024, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1660/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.464/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015994, për pozitën e punës “*Zyrtar për Shërbime Sociale 2*”, në Komunën e Kllokotit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klllokotit, ndërsa kjo e fundit, më datë 11.04.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me Vendim me numër protokollit 2790/2025, të datës 28.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.464/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 1660/2025 të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Dokument identifikimi i ankueses; Konkursin me numër reference RN00015420 të datës 11.10.2024; Njoftimin me numër protokollit 90 të datës 11.02.2025; Konkursin me numër reference RN00015994 të datës 10.12.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 11.04.2024; Vendimin me numër protokollit 36/1 të datës 22.01.2025; Akt emërimit me numër protokollit 4336/1 të datës 21.03.2024; Akt emërimit me numër protokollit 616/1 të datës 22.06.2021; Akt emërimit të datës 18.08.2021; Akt emërimit me numër protokollit 1022/1 të datës 18.09.2020; Akt emërimit të datës 16.09.2011; Lista e aplikantëve; Aplikacioni i kandidatës A.I, i datës 13.12.2024; Aplikacioni i kandidatës D.R, i datës 24.12.2024; Rezultatet e testi me shkrim; Testet me shkrim; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, ***është e pabazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Prishtinës, më datë 10.12.2024 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00015994, për pozitën e punës *”Zyrtar për Shërbime Sociale 2”*, me afat aplikimi nga data 11.12.2024 deri me datë 09.01.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kandidatë, ku prej tyre tre (3) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesen A.I, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim në të cilin ka arritur t’i mbledh 26.4 pikë, nga rrjedh se ankuesja nuk ka arritur t’i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit atë të intervistës me gojë

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 11.02.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokollit 90, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja D.R, me gjithsejtë 92.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidate fituese për pozitën *Zyrtar për Shërbime Sociale 2*.

Ankuesja, kundër njoftimit të lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore për vlerësim jo merit, diskriminues dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke theksuar ndër të tjera se kandidatja fituese nuk ka përvojën e punës, ndërsa ankuesja është eliminuar në fazën e testit me shkrim sepse plotëson kërkesat e përgjithshme formale, si dhe po ashtu e njëjta pretendon përbërja e Komisionit të Pranimit nuk është formuar komfor detyrimeve ligjore, dhe si për rrjedhojë, kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin e konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00015994, për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Sociale 2*, Grupi i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor): Psikologji/Sociologji, Punë Sociale dhe Logopedi; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë*, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të sapo theksuara janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/6 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Profesional 2.

Andaj, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankueses, lidhur me përbërjen e Komisionit të Pranimit, ju referua nenit 40 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*, si dhe nenit 20 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, dhe si për rrjedhojë nga analizimi i Vendimit me numër protokollit 36/1 të datës 22.01.2025, të Kryetarit të Komunës Kllkotit, rezulton se Komisioni i Pranimit është themeluar në pajtim me këto kritere ligjore, ngase në përbërje të tij dhe në vlerësimin e kandidateve në këtë procedurë rekrutimi, kanë marrë pjesë 3 nëpunës të nivelit të mesëm dhe 2 të nivelit profesional.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ju referuar legjislacionit në fuqi, respektivisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, me theks të veçantë nenit 39 ku përcaktohet se: ... *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të*

veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht: Nenit 9 ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa esea mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa esea vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Esea vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit, si dhe nenit 10 paragrafi 9 ku përcaktohet se: 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV).

Kolegji i Këshillit, referuar kuadrit përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses se Komisioni i Pranimit nuk ka bërë vlerësim real gjatë testit me shkrim, nuk qëndron dhe si i tillë është i pa bazuar, ngase nga analizimi i provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë Kolegji ka gjetur se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa nga provat e pranura nga ankuesja, si dhe organi i

punësimi, rrjedh se ankuesja ashtu sikurse kandidatja e përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, mirëpo ankuesja në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledh vetëm 26.4 pikë, respektivisht 20 pikë nga përgjigjet për pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë dhe 6.4 pikë prej 20 pikëve sa ishte maksimumi i pikëve për esenë me shkrim, nga rrjedh se e njëjta nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.*

Ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankueses se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Komisioni i Pranimin në këtë procedurë të rekrutimit nuk ka marr parasysh parimin e meritokracisë, ngase sipas të gjeturave të sipër theksuara dhe shkresave të lëndës rezulton se kandidatja fituese, D.R ka kaluar me sukses testin me shkrim (65.2 pikë) dhe intervistën me gojë (27.2 pikë) duke mbledhur kështu gjithsejtë 92.4 pikë të përgjithshme, dhe duke qenë se e njëjta, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor të lartë theksuar ka bashkangjitur Diplomën me Nr.3954/0421 të lëshuar më datë 26.04.2021, nga Kolegji "Fama", mbi të cilën dëshmohet se e njëjta më datë 05.03.2021, ka mbaruar studimet në programin Psikologji dhe ka fituar titullin Bachelor i Arteve në Psikologji, si dhe sa i përket plotësimit kriterit të përvojës së punës, Kolegji i Këshillit, duke iu referuar praktikës vendimmarrëse dhe të konfirmuar sipas Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/18 të datës 19.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se në rastet kur kërkohet përvoja pune profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit, nga edhe rezulton se kandidatja D.R ka plotësuar kriterin prej një (1) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, ngase bazuar në shkresat e bashkangjitura të lëndës rezulton se e njëjta posedon përvojë pune pas diplomimit, apo konkretisht duke u bazuar në Vendimin me numër protokolli 28/1 të datës 13.01.2022, rezulton se kandidatja në fjalë, nga kjo datë e tutje mbanë pozitën e Zyrtares Administrative në Komunën e Klllokotit, andaj si rrjedhojë e njëjta ka fituar të drejtën për emërim në shërbimin civil, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimin dhe rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit, me rastin e zhvillimit të procedurës se rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës me numër protokolli 90 të datës 11.02.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Sociale 2*, me numër reference RN00015994, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 90, i datës 11.02.2025, për rezultatin final të vlerësimit, të pozitës së punës *Zyrtar për Shërbime Sociale 2*, në Komunën e Klllokotit, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.464/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.I;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.